



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.182 dt.29.09.2000

MBI

**“MIRATIM FONDI NGA TË ARDHURAT E BASHKISË PËR DREJTIM
PUNIMESH DHE KOLAUDIM TË NDRICIMIT TË UNAZËS NË ZONËN NGA
SHESHI K.TOPIA DERI TEK RRUGA S. KODRA”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, i mbledhur me dt.29.09.2000, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Shërbimeve mbi “Miratim fondi nga të ardhurat e Bashkisë për drejtim punimesh dhe kolaudim të ndriçimit të unazës në zonën nga sheshi K.Topia deri te rruga S.Kodra”, bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.42, dt.31.03.2000 “Mbi miratim fondesh për shërbimet publike nga të ardhurat për vitin 2000”, ligjit Nr.8652, dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjit Nr.8402, dt.10.09.1998 “ Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.444, dt.05.09.1994 për “Tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit”, pikaA, VIII

V E N D O S I

1. Të miratojë fondin prej 37.000 lekësh nga të ardhurat e Bashkisë për drejtim punimesh dhe kolaudimin e ndriçimit të unazës në zonën nga sheshi “Karl Topia” deri tek rruga “Siri Kodra” përkatësisht:

1. Për drejtimin e punimeve	25.000 lekë
2. Për kolaudimin e punimeve	12.000 lekë

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Shërbimeve si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI